

RAPORT MBI ANKETIMIN STUDENTOR “CILËSIA E MËSIMDHËNIES ONLINE” SEM.II 2019-2020

Universiteti Politeknik i Tiranës - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. HYRJE

Nisur nga situata e krijuar, me qëllim përmbylljen me sukses të vitit akademik 2019-2020, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe DSBC kanë organizuar anketimin studentor mbi cilësinë e mësimdhënies online për semestrin e dytë.

Realizimi me sukses i procesit mësimor online kishte vështirësitë dhe të panjohurat e veta si nga ana e stafin të pedagogëve ashtu edhe nga ana e studentëve. Megjithatë, ky proces u përmbyll dhe për të kuptuar më mirë vështirësitë, sfidat dhe perceptimin e studentëve në lidhje me të, u organizuar ky anketim.

Mendimi dhe vlerësimi i studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies është shumë i rëndësishëm në mënyrë që UPT të marrë masat e nevojshme dhe të jetë më i përgatitur në rastin e një skenari të mundshëm të mbylljes së universiteteve, ashtu siç ndodhi në Mars të 2020.

Në këtë raport të hartuar nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), paraqiten rezultatet e përftuara nga anketimi i studentëve në lidhje me procesin mësimor online si dhe rekomandime të vlefshme për njësitë kryesore dhe njësitë bazë.

PËRMBAJTJE

<u>1. HYRJE</u>	<u>1</u>
<u>2. ORGANIZIMI I PYETËSORIT</u>	<u>3</u>
2.1. QËLLIMI I PYETËSORIT	3
2.2. PYETJET E SONDAZHIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT	4
2.3. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR ANALIZIMIN E TË DHËNAVE	4
<u>3. REZULTATET E SONDAZHIT STUDENTOR</u>	<u>4</u>
3.1. PJESËMARRJA E STUDENTËVE	4
3.2. EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE NË RANG INSTITUCIONI (UPT)	6
3.3. REZULTATET E VLERËSIMIT SIPAS FAKULTETEVE	7
3.4. KOMENTE TË MARRA NGA ANKETIMI:	10
3.5. REKOMANDIMET DHE PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT	11
<u>4. ANEKSE</u>	<u>12</u>
4.1. RANKIMI I REZULTATEVE SIPAS CDO FAKULTETI	12
4.2. PASQYRA E REZULTATEVE NË NIVEL PROGRAMI STUDIMIT	12

2. Organizimi i pyetësorit

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligj Nr. 80/2015, Neni 103, Pika 3 dhe sipas përcaktimeve të Planit të Veprimit, DSBC organizon Pyetësorit Studentor lidhur me cilësinë e mësimdhënies online.

Për të garantuar pjesëmarrje dhe njohjen sa më të mirë me procesin, studentët u informuan përmes e-mail-it në lidhje me kohën e kryerjes së anketimit, mënyrën e plotësimit dhe rëndësinë e këtij procesi.

Nëpërmjet këtij pyetësori, çdo studenti ju dha mundësia të shprehë perceptimin dhe përvojën e tij mbi procesin e mësimdhënies online duke u fokusuar tek problemet dhe vështirësitë e hasura.

Pyetësori u plotësua vetëm një herë dhe jo për çdo lëndë.

Pyetësori studentor u zhvillua prej datës 18 Qershor, deri më 04 Korrik 2020 nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore: <https://bit-albania.com/upt6.php>.

Pjesë e këtij anketimi kanë qënë fakultetet të cilat disponojnë sistemin online të sekretarisë mësimore:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)
3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)
4. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM)
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)
6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF)

2.1. Qëllimi i Pyetësorit

Ashtu si çdo semestër, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) organizon pyetësorë studentor, me qëllimin e vetëm të evidentimit të problemeve, mangësive në të gjitha hallkat e mësimdhënies, duke filluar nga niveli universitar deri tek pedagogët e lëndëve.

Ndryshe nga 4 sondazhet e parë, në kushtet e pandemisë globale nga Covid-19, kemi organizuar një sondazh që nxjerr në pah të gjitha problematikat, mangësitë që kanë hasur studentët gjatë zhvillimit të mësimi online.

Procesi i përshtatjes në një kohë rekord nga mësimi në auditor tek mësimi online ka qënë i vështirë dhe i panjohur si nga studentët, ashtu edhe nga pedagogët.

Vlen të theksohet se, ashtu si në sondazhet e mëparshme, është garantuar anonimati i studentëve dhe është garantuar konfidencialiteti i të dhënave të pyetësorit.

Nëpërmjet këtij sondazhi studentor jemi munduar të kuptojnë perceptimin/mendimin e studentëve mbi mësimdhënien online, të përmbledhur në katër këndvështrime kryesore, të cilat evidendohen nëpërmjet 9 pohimeve:

- Cilësia në mësimdhënie – P1, P2, Vlerësimi me notë
- Pjesëmarrja në mësim - Vlerësimi nëpërmjet P7
- Interaktiviteti – Vlerësimi nëpërmjet P4, P5, P6
- Efektshmëria në mësimdhënie - Vlerësimi nëpërmjet P3, P8, P9

Ky pyetësor ka për qëllim të evidentojë problemet e hasura gjatë mësimdhënies online (sipas një analize statistikore) në nivel:

- Nivel Universiteti
- Nivel njësie kryesore (Fakulteti)

2.2. Pyetjet e sondazhit dhe kriteret e vlerësimit

Për të përmbushur qëllimin e këtij Sondazhi, u mendua që pyetjet të jenë të thjeshta për t'u kuptuar nga të gjithë.

- (P1) Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.
- (P2) Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor
- (P3) Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.
- (P4) Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.
- (P5) Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimi.
- (P6) Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.
- (P7) Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.
- (P8) Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.
- (P9) Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.
- (Nota) Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.
- (Komenti)

Pyetësi plotësohet vetëm një herë nga studentët dhe çdo pohim të cituar më lart studentët e vlerësojnë me pikë nga 1 (nuk jam aspak dakord) deri në 5 (jam plotësisht dakord) për nëntë pyetjet e para.

Për një vlerësim më të përgjithshëm studenti vlerëson në tërësi cilësinë e mësimi online edhe me një notë e cila mund të ketë vlerën nga 1-10.

Në fund, sipas dëshirës, studenti mund të japi edhe një vlerësim nëpërmjet një komenti me shkrim, duke shprehur në këtë mënyrë edhe mendimin e tij se si mund të përmirësohet ky proces.

2.3. Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave

Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara nga sistemi, u realizua një analizë statistikore në disa nivele:

- Nivel Institucioni
- Nivel Fakulteti

Në këtë mënyrë, u nxor për të gjitha nivelet e analizës mesatarja aritmetike për çdo pyetje nga P1 deri në P9, mesatarja aritmetike për vlerësimin me notë. Gjithashtu, për rezultatet në nivel Institucioni (UPT) është llogaritur edhe moda dhe mediana, si tregues më të avancuar të trendit të përgjigjeve.


3. Rezultatet e Sondazhit studentor

3.1. Pjesëmarrja e studentëve

Numri i anketimeve, për rrjedhojë edhe i studentëve (duke qenë se ky pyetësor është plotësuar vetëm njëherë nga 1 student, pra jo për çdo lëndë) për të gjithë fakultetet pjesë e procesit të sondazhit është 648 ANKETIME / STUDENTË, të shpërndara nëpër Fakultetet përkatëse.

Fakulteti	Nr. i studentëve pjesëmarrës
FTI	217
FAU	155
FIE	122
FIN	83
FGJM	40
FIMIF	31
Total (UPT)	648

Tabela e shpërndarjes së pjesëmarrjes të studentëve sipas fakulteteve



Paraqitja grafike e shpërndarjes së pjesëmarrjes së studentëve sipas fakulteteve

3.2. Evidentimi i problematikave në rang Institucioni (UPT)

PYETJET		VLERESIMI - UPT
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.219
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	4.014
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.637
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	3.802
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimi.	3.569
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	3.725
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.577
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.699
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	3.145
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	6.887

Duke u bazuar tek 9 pohimet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuara janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.699

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 3.145

Duke pasur parasysh se nëpërmjet këtij pyetësi duam të kuptojmë perceptimin e studenteve mbi përmbushjen e procesit mësimor në katër aspekte kryesore:

- Cilësia në mësimdhënie – P1, P2, Vlerësimi me notë
- Pjesëmarrja në mësim - Vlerësimi nëpërmjet P7
- Interaktiviteti – Vlerësimi nëpërmjet P4, P5, P6
- Efektshmëria në mësimdhënie - Vlerësimi nëpërmjet P3, P8, P9

Nga të dhënat e përgjithshme rezulton se mësimdhënia është zhvilluar e plotë dhe në përputhje me kalendarin akademik. Studentët rezultojnë të kënaqur me nivelin e informacionit të marrë në fillim të semestrit në lidhje me programin mësimor.

Ndërkohë, nga të dhënat e mësipërme rezulton se për studentët e UPT mësimi online nuk ka rezultuar aq i efektshëm sa mësimi në auditor. Ky perceptim i studentëve në fakt lidhet ngushtë me natyrën e programeve të studimit dhe nivelin e vështirësisë së lëndëve me natyrë shkencore.

3.3. Rezultatet e vlerësimit sipas Fakulteteve

Në tabelat në vijim, janë theksuar indikatorët të cilët meritojnë vëmendje në interpretim nga njësitë përkatëse.

☐ Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)

PYETJET		VLERESIMI - FAU
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	3.852
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	3.735
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.387
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	3.606
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimi.	3.381
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	3.690
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.594
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.787
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	3.316
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	6.497

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuar janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.789

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 3.316

☐ Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM)

PYETJET		VLERESIMI - FGJM
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.175
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	3.925
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.400
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	3.675
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimi.	3.450
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	3.550
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.575
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.925
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	3.125
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	6.775

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuar janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.925

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 3.125

☐ Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)

PYETJET		VLERESIMI - FIE
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.352
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	3.893
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.770
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	3.861
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimit.	3.795
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	3.934
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.615
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.607
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	3.090
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	7.033

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuar janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.607

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 3.090

☐ Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF)

PYETJET		VLERESIMI - FIMIF
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.129
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	4.032
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.452
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	3.548
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimit.	3.613
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	4.000
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.581
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.645
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	2.903
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	7.000

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuar janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.645

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 2.903

☐ Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)

PYETJET		VLERESIMI - FIN
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	3.783
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	3.602
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.337
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	3.229
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimit.	3.036
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	3.843
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.843
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.193
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	2.687
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	5.651

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuar janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.193

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 2.687

☐ Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)

PYETJET		VLERESIMI - FTI
P1	Në fillim të semestrit, përmes komunikimit online jeni informuar për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.594
P2	Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me orarin mësimor	4.452
P3	Komunikimi online me pedagogët gjatë procesit mësimor është i thjeshtë dhe efektiv.	3.926
P4	Platformat online të përzgjedhura, përputhen me nevojat dhe specifikat e lëndëve.	4.189
P5	Komunikimi online me pedagogët ka vijuar edhe përtej orës së mësimit.	3.797
P6	Mësimdhënia online paraqet problematika teknike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies.	3.581
P7	Pjesëmarrja në mësim është ndikuar nga mungesa e mjeteve/pajisjeve të nevojshme dhe lidhjes së internetit.	3.442
P8	Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor.	2.848
P9	Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.	3.267
Nota	Vlerësoni me notë cilësinë e mësimdhënies gjatë këtij semestri.	7.562

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e sondazhit, aspektet më problematike të evidentuar janë:

P8: Mësimdhënia online rezulton po aq e efektshme sa mësimdhënia në auditor: 2.848

P9: Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies: 3.267

3.4. Komente të marra nga anketimi:

Komentet e paraqitura në vijim, janë përzgjedhur për të ilustruar problematikat e dala nga anketimi. Gjithsesi, këto komente i referohen kryesisht pikave të dobëta por nuk mund të përdoren si referencë kundrejt vlerësimeve të përgjithshme të analizuara në këtë raport.

FAK.	GRUPI	KOMENTET E STUDENTËVE
FAU	Urbanistika_2019-2020	Mesimi online ka qene plotesisht nje deshëm Shume veshitresi ne kuptimin e mesimeve dhe gjate zhvillimit te detyrave te kursit
	Arkitektura_2019-2020	Nuk eshte marre aspak parasysh fakti qe disa nga studentet per shkak te pandemise jane larguar neper rrethe dhe kane patur veshitresi ndjekjen online te mesimdhënies si mungese e mjeteve te punes dhe internetit dhe nga kjo arye shume studente nuk kane mundur te lajmerohen ne kohe per ndryshime te mu
FIE	Elektrike Automatizim Industrie_2019-2020	Pamundesi qasje per mesim online si dhe mesimi online nuk e zevendeson ate ne auditor
	Elektrike Energjetike_2019-2020	Duhet te zhvillohet dhe semestri i pare online dhe ne auditore ne menyre qe vitet e tjera te kene aksesim ne to pasi mund te jene nje ndihme mjaft e madhe
	M P Automatizim Industrie_2019-2020	Eshte normale qe ka nje "hendek" te madh ndermjet dy metodave te mesimdhënies. Kjo si pasoje e ndikimit te shume faktoreve nder te cilat 1-Programet e komunikimit video & audio jane me pagese dhe per pasoje jane te limituara. 2-Ne rast te ndonje paqartësie eshte mjaft e veshitresi te kerkosh nje rishpjegim te problematikes pasi nuk jemi ne prezencen e mjeteve mesimore si derrasa dhe mjetet me te cilat te behet transmetimi balle perballe.
	Mekatronikë_2019-2020	Mesimdhënja online eshte e efektshme ne disa lende me teper ne leksione mundesisht te regjistruara me pare dhe me pas te postuara ne klase. Eshte dicka e mire sepse mund ta shikosh dhe rishikosh nje leksion disa hereb njesoj si leksionet e profesor XXX te cilat i ka publikuar ne youtube. Shembull
	Mekatronikë_2019-2020	Mendoj se te gjithë studentet kane te nevojshme disa jave perseritje te koncepteve kryesore dhe ushtrimeve kyAfÂs ne auditore para se te hyjme ne provime.Mesimi online ka qene disi efektiv por nuk e zevendeson kurrsesi punen ne ambientet e fakultetit.
FIIN	Ndërtim_2019-2020	Nuk suportoj ne asnje menyre vazhdimin e mesimit online! Asgje nuk esht efektive. Nuk mesohen lendet e inxhinierise nepermjet internetit.. Nuk me intereson fare pandemia.. Dua te rikthehem ne auditor me masa mbrojtëse.. Faleminderit
	Ndërtim_2019-2020	Nuk bahet msim online! Asht e pamundun per me e kry rregullisht msimin online
FTI	Inxhinieri Informatike_2019-2020	Pavaresisht perpjekjes se profesoreve mesimdhënja nuk eshte njejt cilesi edhe prej shkaqeve psiko-emocionale. Nuk mendoj se kemi perfutur as gjysmen e njohurive qe do mund te perfitonim ne auditore
	Inxhinieri Telekomunikacioni_2019-2020	Mesimdhënja online eshte nje zgjedhje e mire per aq kohe sa eshte e perkohshme.

3.5. Rekomandimet dhe propozimet për përmirësimin e treguesve të ulët

Duke u bazuar nga analizat e mësipërme dhe komentet e studentëve mbi procesin mësimor online të zhvilluar gjatë vitit akademik 2019-2020, DSBC ka hartuar disa rekomandime të cilat synojnë të marrin vëmendjen e nevojshme të drejtuesve të fakulteteve dhe pedagogëve nëse ky proces mësimor do të vazhdojë të zhvillohet online edhe në vitin e ri akademik 2020-2021.

Sipas perceptimit të studentëve (rezultatet statistikore), mësimi online nuk ka efektshmëri të duhur, krahasuar me mësimin në auditor.

Megjithatë, mësimi online është zgjidhja më e mirë e mundshme në kushtet aktuale dhe si i tillë ai duhet të përmirësohet vazhdimisht në kushtet kur një eksperience e tillë e mësimi online u realizua në semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

Në këto kushte, DSBC rekomandon marrjen e masave në nivel Universiteti dhe Fakulteti si më poshtë:

- Raporti i anketimit Studentor 2019-2020, SEM.II, të analizohet dhe të diskutohet nga të gjithë drejtuesit e njësive kryesore dhe atyre bazë me stafin e pedagogëve.
- Të shihet mundësia e alternimit të mësimi online dhe në auditor (për vitin e ri akademik 2020-2021), pa cënuar sigurinë shëndetësore të studentëve dhe pedagogëve, duke respektuar rregullat anti-covid në fuqi.
- Të përzgjidhen metodat dhe platformat më të përshtatshme për zhvillimin e mësimi online sipas specifikave të çdo programi studimi. Të merren masa administrative për abonimet dhe kostot e tjera operative për mirëfunksionimin e këtyre platformave.
- Të krijohet një mekanizëm kontrolli në lidhje me zhvillimin e mësimi online si dhe ngarkimin e materialeve të leksioneve dhe seminareve në platformat e përzgjedhura.
- Të krijohen instrumente në nivel fakulteti për komunikimin me studentët përmes email-eve ose formave të tjera të komunikimit elektronik.

4. ANEKSE

- 4.1. Rankimi i rezultateve sipas cdo fakulteti.
- 4.2. Pasqyra e rezultateve në nivel programi studimit.